Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat e Investimeve në Ndërmarrje 2024

Prishtinë, 2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat e Investimeve në Ndërmarrje 2024

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Prishtinë, 2026

Botues: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Shkurt, 2026
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së:
http://ask.rks-gov.net

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës ka përgatitur publikimin për Statistikat e Investimeve në Ndërmarrje në Kosovë për vitin 2024. Statistikat e investimeve si pjesë e programit të ASK-së kanë filluar të publikohen në vitin 2019 për vitin referues 2018, duke i publikuar vetëm në nivel të anketës deri ne vitin 2020. Ndërsa nga viti 2021 këto të dhëna publikohen në nivel vendi.

Ky hulumtim ofron të dhëna për blerjet investive në ndërtim, blerjet investive në makineri dhe pajisje, blerjet investive në produktet e pronësisë intelektuale dhe aseteve me vlerë, blerjet investive biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi si dhe blerjet investive të tjera në asetet e prekshme apo jo të prodhuara.

Publikimi do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në email adresën infoask@rks-gov.net

Publikimin e përgatitën:

Ilir T. Berisha – Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike
Bekim Bojku – Udhëheqës i Divizionit të Statistikave Ekonomike
Violeta Syla – Zyrtare e lartë për Statistika të Tregtisë së Jashtme
Guxim Neziri – Administrator i lartë i TI-së për baza të të dhënave
Vesa Tmava – Konsulente
Valbona Hoti – Konsulente

Drejtor Ekzekutiv, ASK
Avni Kastrati

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

NVE - Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike

RSB - Regjistri Statistikor i Bizneseve

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

Simbolet

: - Mungojnë të dhënat

Përmbajtja

Faqe

1. Metodologjia dhe përkufizimet 8
1.1. Metodologjia 8
1.2. Mbulimi 9
1.3. Përkufizimet 10
1.3.1. Investimet në ndërtim (ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore) përfshijnë: 10
1.3.2. Investimet në makineri dhe pajisje 10
1.3.3. Investimet në produktet e pronësisë intelektuale dhe aseteve me vlerë 11
1.3.4. Investimet biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi përfshijnë 12
1.3.5. Investimet e tjera në asetet e prekshme (jo të prodhuara) përfshijnë 12
2. Rezultate e Anketës, Statistikat e Investimeve 2024 13
2.1. Investimet sipas aktivitetit ekonomik 14
2.2. Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve 15
2.3. Investimet sipas regjioneve 16
2.4. Blerjet e reja, të importuara dhe investime në vijim 17
2.5. Burimet e mjeteve për financimin e investimeve 18
3. Investimet sipas kategorive 19
4. Investimet Qeveritare 22

1. Metodologjia dhe përkufizimet

1.1. Metodologjia

Anketa është kryer në tërë territorin e Kosovës, në ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar në ATK, se kanë pasur blerje investive gjatë vitit 2024. Për qëllime të kësaj ankete, "*Blerje investive"* nënkupton blerjen e mallrave kapitale: të prekshme (ndërtesa dhe struktura ndërtimore, makineri dhe pajisje, plantacione dhe serra bujqësore, kafshë, blerja e pronësisë mbi tokën etj.) dhe të paprekshme (licenca, patente, softuerë, etj.) të cilat kanë vlerë më të madhe se 1000 €, jetëgjatësi më tepër se një vit dhe përdoren për të krijuar pasuri apo gjeneruar të ardhura.

Korniza e mostrës përbëhet nga lista e ndërmarrjeve që kanë deklaruar blerje *investive* në deklaratat e TVSH-se për vitin 2024 në njërën nga këto kategori:

- [32] Blerjet dhe importet investive pa TVSH,
- [34] Blerjet dhe importet investive me TVSH,
- [39] Importet investive me normë 18%,
- [41] Importet investive me normë 8%,
- [47] Blerjet investive vendore me normë 18%,
- [49] Blerjet investive vendore me normë 8%.

Sipas këtyre deklarimeve, popullacioni për vitin 2024 ishte 11,201 ndërmarrje, në vlerë rreth 1,310 Mil Euro. Në mostër janë përfshirë të gjitha ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar blerje *investive vjetore mbi shumën 100,000 euro* gjatë vitit 2024. Sipas këtij kriteri numri i ndërmarrjeve në mostër ishte 1,298.

Të dhënat janë grumbulluar përmes tabletave nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë në ndërmarrje. Shkalla e përgjigjeve e realizuar prej 54.2% të njësive raportuese ose në vlerë të blerjeve investive prej 870 Mil Euro ka shërbyer si bazë për të paraqitur strukturën e blerjeve investive, për të ngritur të dhënat në pesha dhe për të llogaritur rezultatet në nivel vendi.

	Popullacioni	**2024**
1	Numri i ndërmarrjeve në popullacion	11,201
2	Numri i ndërmarrjeve të zgjedhura në mostër	1,298
3	Numri i pyetësorëve të plotësuar nga ndërmarrjet në teren	704
4	Numri i rasteve të klasifikuara si të pa përgjigjur, këtu përfshihen refuzimet, rastet kur nuk ka pasur përgjigje ose ndonjë komunikim	590
5	Të pagjetura	3
6	Ndërmarrjet Pasive/Shuara	1
	Shkalla e përgjigjeve në %	**54.2**

1.2. Mbulimi

Të dhënat me bazë vjetore që janë shfrytëzuar për publikim janë për vitin 2024. Në vrojtim u mbuluan ndërmarrjet e zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Bizneseve të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NACE Rev.2 në nivel sektori:

Sektorët	Përshkrimi i sektorëve
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari
B	Xehetari dhe gurëthyes
C	Prodhim
D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës
F	Ndërtimtari
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave
H	Transport dhe ruajtje
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim
J	Informacion dhe komunikim
K	Aktivitete financiare dhe sigurimit
L	Aktivitete të patundshmërisë
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse
O	Administratë publike dhe mbrojtje
P	Arsim
Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale
R	Art, zbavitje dhe rekreacion
S	Aktivitete të shërbimeve tjera

Blerjet investive në anketë janë shpërndarë në pesë kategori:

1. Investimet në ndërtim (ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore)
2. Investimet në makineri dhe pajisje
3. Investimet në produktet e pronësisë intelektuale dhe aseteve me vlerë
4. Investimet biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi
5. Investimet e tjera në asetet e prekshme(jo të prodhuara)

Po ashtu, blerjet investive në këtë anketë janë ndarë edhe sipas llojit të blerjeve:

1. Blerje investive të reja - të pa përdorura më parë (vendore)
2. Blerje investive të vjetra - të përdorura më parë (vendore)
3. Blerjet investive në vijim - që nuk janë në shfrytëzim deri më 31.12.2024 (vendore)
4. Blerjet investive të importuara

1.3. Përkufizimet

- **Blerjet investive të reja (të pa përdorura më parë)** - nënkupton të gjitha investimet të cilat nuk kanë qenë në funksion (shfrytëzim) më parë nga ndërmarrjet tjera të Kosovës.

- **Blerjet investive të vjetra (të përdorura më parë)** - nënkupton të gjitha investimet të cilat para blerjes kanë qenë në funksion (shfrytëzim) të ndonjë ndërmarrje tjetër në Kosovë. Këto blerje nuk konsiderohen si investime në nivel vendi.

- **Blerjet investive në vijim (nuk janë në shfrytëzim deri më 31.12.2024)** - nënkupton investimet e papërfunduara të cilat nuk kanë qenë në funksion (shfrytëzim) nga ndërmarrja gjatë vitit dhe

- **Të importuara** - nënkupton të gjitha investimet në makineri dhe pajisje, të cilat ndërmarrja i ka blerë jashtë vendit gjatë vitit 2024.

1.3.1. Blerjet investive në ndërtim (ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore) përfshijnë:

- **Ndërtesa dhe hapësira të banimit** – përfshinë një ndërtesë banimi me një, dy, tre ose më shumë apartamente dhe shtëpi për banim.

- **Ndërtesa dhe hapësira jo-banimi** - përfshinë hotelet dhe ndërtesat e ngjashme, ndërtesat e zyrave, ndërtesat për transport dhe komunikim, ndërtesat industriale dhe depo, spitale dhe ndërtesa shëndetësore, ndërtesat arsimore dhe edukative, ndërtesat për veprimtari kulturore, artistike dhe sportive.

- **Ndërtime metalike** - përfshinë konstruksione të ndryshme nga metalet si; salla sportive, depo, shtylla elektrike, tezga, tabela të reklamave dhe të tjera të ngjashme.

- **Infrastruktura e transportit** - përfshinë autostradat, rrugët, hekurudhat, shtigjet e aeroportit, urat, tunelet, digat, brigje lumi dhe tjera të ngjashme.

- **Tubacionet, linjat e komunikimit dhe ato elektrike** - përfshinë tubacionet për furnizim me ujë, tubacionet për kanalizim, linjat e telekomunikacionit dhe transmetimit elektrik.

- **Ndërtimet komplekse industriale** - përfshinë termocentralet, ndërtesat për miniera dhe të tjera të ngjashme.

- **Përmirësimi i tokës** - përfshinë mbrojtjen nga përmbytjet, kanalet, masat hidroteknike, bonifikimi i tokave dhe të tjera të ngjashme.

- **Ndërtesa tjera - të pa përmendura** - përfshinë ndërtesat për sport dhe rekreacion, objektet ushtarake, deponitë dhe të tjera të ngjashme.

1.3.2. Blerjet investive në makineri dhe pajisje

- **Automjetet e udhëtarëve (pasagjerëve)** – përfshinë auto veturat, furgonët, autobusët, motoçikletat dhe tjera të ngjashme për transportin e udhëtarëve.

- **Automjetet e mallrave** – përfshinë kamionë transportues të mallrave (deri në 5 ton; nga 5 ton deri 20 ton dhe mbi 20 ton) dhe rimorkio.

- **Automjete dhe pajisje të tjera** – përfshinë të gjitha mjetet e transportit me motor për qëllime të veçanta (p.sh. kamionët për auto-bartje, kamionët vinç, mjetet e transportit për shuarjen e zjarrit, auto betonierët, mjetet për pompimin e betonit, makinat për pastrimin e borës nga rruga, makinat për larje të rrugës, ofiçinat e lëvizshme, njësitë radiologjike të lëvizshme).

- **Produkte metalike** - përfshinë strukturat metalike, tankerët (cisterna), rezervuarët, kontejnerët, kaldajat dhe pajisjet e ngrohjes qendrore dhe tjera të ngjashme.

- **Makineritë e tjera për qëllime të përgjithshme** – përfshinë makinat për prodhimin dhe shfrytëzimin e energjisë mekanike (motorë, turbina, pompa, kompresorë), vegla makinerish (për ngritje, transport, ftohje, ventilim), peshore dhe tjera të ngjashme.

- **Makineritë e tjera për qëllime të veçanta** – përfshinë makineritë metalurgjike, makineritë për miniera dhe ndërtime, makineritë për industri përpunuese (mulli gruri, ushqimore, tekstilit, përpunim të metaleve , drurit, gurit etj.) dhe tjera te ngjashme.

- **Makina dhe pajisje të tjera elektrike** – përfshinë motorë elektrik, gjeneratorë, transformatorë, pajisje shpërndarëse për energji elektrike, sistemet e ndriçimit në rrugë dhe në natyrë, gjeneratorë me avull dhe tjera të ngjashme.

- **Makineri bujqësore** – përfshinë traktorë, kombajna dhe makineri tjera bujqësore dhe pyjore.

- **Kompjuterë dhe pajisje kompjuterike-periferike** – përfshinë kompjuterë, laptopë, printerë, skanerë, fotokopjues, tabletë dhe tjera të ngjashme.

- **Pajisje të komunikimit dhe aparatet elektronike** – përfshinë pajisjet dhe aparatet e radios, televizionit dhe komunikimit, (radio transmetues, telefon, faks) dhe tjera të ngjashme.

- **Pajisje dhe instrumente mjekësore** – përfshinë pajisje dhe instrumente për qëllime mjekësore (ultrazë, CT, rezonanca magnetike, rëntgen, laparoskop, aparate laboratorike, mikroskop, otoskop), instrumente të përdorura në stomatologji, pajisje optike dhe tjera të ngjashme dhe

- **Pajisje dhe instrumente tjera** – përfshinë pajisje dhe instrumente muzikore, sportive, për lojëra të ndryshme dhe tjera të ngjashme.

1.3.3. Blerjet investive në produktet e pronësisë intelektuale dhe aseteve me vlerë

- **Blerjet e patentave, licencave dhe të drejtave të autorit** - përfshinë blerjet e bëra në patenta, licenca dhe të drejta të autorit për qëllime të prodhimit të të mirave materiale dhe shërbimeve.

- **Hulumtimi dhe zhvillimi për nevojat e ndërmarrjes** - përfshinë shpenzimet e bëra në kërkim dhe zhvillim të kryera nga vet ndërmarrja për nevoja të saj.

- **Eksplorime gjeologjike (Eksplorimi i minierave dhe mineraleve) -** përfshinë shpenzimet e bëra për hulumtimet gjeologjike (xeheve, gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gipsit, shkumësit dhe rrasave, mineraleve kimike etj.).

- **Softueri i blerë (licencat e softuerit)** - nënkupton një licencë softuerësh i cili është një dokument që siguron udhëzime ligjërisht të detyrueshme për përdorimin dhe shpërndarjen e softuerit.

- **Softuerë të zhvilluar për nevoja të biznesit** - nënkupton softuer që janë përvetësuar ose zhvilluar për të përmbushur nevojat e brendshme të një biznesi.

- **Bazat e të dhënave të blera** - nënkupton blerjen e bazave të të dhënave të gatshme.

    - **Bazat e të dhënave të prodhuara** - nënkupton krijimin e bazës së të dhënave të cilat krijohen nga vetë biznesi vetëm për nevoja vetanake të atij biznesi.

    - **Krijime origjinale artistike dhe letrare** - përfshinë filma, radio dhe programe televizive, vepra muzikore dhe të tjera dhe

    - **Koncesionet, licencat, lejet e tjera të punës dhe të drejtat e ngjashme që nuk janë përmendur më lart** - përfshinë një vepër ose shpikje që është rezultat i krijimtarisë, siç është një dorëshkrim ose një model, për të cilin dikush ka të drejta dhe për të cilin mund të kërkojë një patentë, të drejtën e autorit, markën tregtare, etj.

1.3.4. Blerjet investive biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi përfshijnë

- **Kopetë primare (shtazore) që japin produkte të përsëritura** - përfshinë blerjën e kafshëve (Lopë, dele, dhi, buallica, kuaj dhe tjera të ngjashme) për qëllime të mbarështimit dhe prodhimin e produkteve të përsëritura (qumështit, leshit etj.) duke përjashtuar kafshët për therje.

- **Plantacionet afatgjata (më shumë se një vit)** – përfshinë shpenzimet e bëra për mbjelljen e sipërfaqes tokësore apo sipërfaqet e mbjellura me molla, arra, rrush, kumbulla, dardha, pjeshka, mjedra, qershia dhe tjera të ngjashme për qëllime të prodhimit të frutave që kanë jetëgjatësi dy e më shumë vite dhe

- **Serrat** – përfshinë shpenzimet e bëra për ndërtimin ose blerjen e serrave (si konstruksion) për kultivimin e produkteve të ndryshme bujqësore.

1.3.5. Blerjet investive të tjera në asetet e prekshme (jo të prodhuara) përfshijnë

- **Blerja e tokës** – përfshinë blerjen e tokës, depozitave nëntokësore, pyjeve dhe ujërave.

- **Shpenzimet e transferimit të pronësisë mbi tokën** – përfshinë koston e transferimit të pronësisë mbi tokën të bëra nga blerësi duke përfshirë shpenzimet noteriale (blerja e tokës nuk përfshihet) dhe

- **Blerja e produkteve të çmuara** – përfshinë blerjen e produkteve të çmuara (gurë të çmuar dhe metale të tilla si diamante, ari jo monetar, platini, dhe mjete argjendi), vepra artistike të vjetra (piktura, skulptura dhe tjera të ngjashme).

2. Rezultatet e Anketës, Statistikat e Investimeve në Ndërmarrje 2024


Sipas rezultateve në nivel vendi vlera e blerjeve investimeve në ndërmarrje në total në vitin 2024 ishte 1,259,923,138 €. Në këtë publikim blerjet e vjetra nuk konsiderohen si blerje investive në nivel vendi, pasi që ato kanë qenë në funksion (shfrytëzim) të ndonjë ndërmarrje tjetër në Kosovë. Blerjet investive në ndërtim zënë peshën kryesore, me 46.66% të blerjeve investimeve në kuadrin e blerjeve investimeve totale të ndërmarrjeve. Blerjet investive tjera që zënë një peshë të konsiderueshme janë ato në makineri dhe pajisje me 45.13%, ndërsa blerjet investive tjera me një peshë më të vogël në kuadrin e totalit të blerjeve investive janë: blerjet investive në asete të prekshme me rreth 4.90%, blerjet investive në produktet e pronësisë intelektuale me 3.31%, si dhe blerjet investive biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi me 0.00% (shih Figurën 1).

Tab. 1: Vlera e blerjeve investive sipas kategorive për vitin 2024

(në mijë euro)

Blerjet investive sipas kategorive	Blerjet investive të reja	Blerjet investive të vjetra	Blerjet investive të importuara	Blerjet investive në vijim	Gjithsej 2024
	a	b	c	d	e=a+c+d
Investime në Ndërtim	519 855	16 592	-	75 081	594 936
Investime në makineri dhe pajisje	468 356	34 025	89 041	-	557 397
Investime në produktet e pronësisë intelektueale	24 797	-	18 384	140	43 321
Investime biologjike në bujqësi	13	-	-	-	13
Investime në asete të prekshme	58 863	-	-	5 393	64 256
Gjithsej blerje investive 2024	**1 071 884**	**50 617**	**107 425**	**80 614**	**1 259 923**

Fig. 1: Struktura e blerjeve investive sipas kategorive për vitet 2023 - 2024, (%)



2.1. Blerjet investive sipas aktivitetit ekonomik


Nëse shikojmë blerjet investive sipas aktivitetit ekonomik, aktivitetet me më së shumti blerje investive janë: Tregtia me shumicë dhe pakicë me 20.16%, Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqime me 18.67%, Prodhimi me 16.48%.

Tab. 2: Struktura e blerjeve investive sipas aktivitetit ekonomik dhe kategorive të blerjeve investive për vitet 2023-2024

(%)

Sektoret/ Viti	Përshkrimi i sektorëve	Blerje investive në ndërtim		Blerje investive në makineri dhe pajisje		Blerje investive në produktet e pronësisë intelektuale		Blerje investive biologjike në bujqësi		Blerje investimve në asete të prekshme		Gjithsej investime	
		2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	0.67	0.30	0.26	0.20	0.06	0.02	100.00	100.00	0.00	0.00	0.57	0.23
B	Xehetari dhe gurëthyes	0.44	0.78	1.82	0.86	0.00	0.00	0.00	0.00	2.37	0.35	1.00	0.77
C	Prodhim	15.85	10.34	36.62	23.77	2.40	1.52	0.00	0.00	11.29	17.97	21.70	16.48
D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	10.60	6.97	6.81	4.72	39.17	7.79	0.00	0.00	0.00	0.00	9.01	5.64
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	3.43	4.00	0.74	2.42	1.65	2.20	0.00	0.00	0.00	0.00	2.34	3.03
F	Ndërtimtari	29.10	5.11	7.29	21.16	2.94	0.06	0.00	0.00	27.56	2.00	21.98	12.03
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	20.62	20.34	24.08	14.42	13.96	46.05	0.00	0.00	48.78	53.93	23.62	20.16
H	Transport dhe ruajtje	8.97	0.91	3.96	5.95	0.89	0.01	0.00	0.00	3.33	0.00	6.93	3.11
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	2.00	32.05	1.60	8.11	3.88	0.02	0.00	0.00	0.00	1.05	1.75	18.67
J	Informacion dhe komunikim	1.18	3.00	0.65	8.97	0.84	21.11	0.00	0.00	1.03	12.39	1.00	6.75
K	Aktivitete financiare dhe sigurimit	0.15	0.90	2.24	1.90	32.14	19.22	0.00	0.00	0.00	0.00	1.17	1.91
L	Aktivitete të patundshmërisë	1.52	0.92	5.16	0.08	1.12	0.00	0.00	0.00	2.02	7.00	2.66	0.81
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	3.00	3.75	1.10	0.72	0.34	0.97	0.00	0.00	3.56	1.99	2.43	2.21
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	0.43	6.47	3.91	2.65	0.60	0.44	0.00	0.00	0.00	0.59	1.47	4.26
O	Administratë publike dhe mbrojtje	0.01	0.07	0.18	0.13	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.06	0.09
P	Arsim	0.43	1.72	0.80	0.79	0.01	0.00	0.00	0.00	0.01	0.00	0.51	1.16
Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	0.14	1.17	2.12	2.31	0.00	0.24	0.00	0.00	0.04	2.27	0.74	1.70
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	0.86	0.97	0.40	0.57	0.00	0.03	0.00	0.00	0.00	0.47	0.65	0.73
S	Aktivitete të shërbimeve tjera	0.60	0.23	0.25	0.29	0.00	0.31	0.00	0.00	0.00	0.00	0.44	0.25
Gjithsej		100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	0.00	100.00	100.00	100.00	100.00

Fig. 2: Struktura e blerjeve investive sipas aktivitetit ekonomik për vitet 2023-2024, (%)



2.2. Blerjet investive sipas madhësisë së ndërmarrjeve


Nga Tabela 3 mund të vërehet se edhe në vitin 2024 perqindja me e madhe e blerjeve investive të ndërmarrjeve kosovare është në dy kategoritë e para, që janë Ndërtimi dhe Pajisje dhe Makineri, ku janë të koncentruara mbi 90% të investimeve, pavarësisht madhësisë së ndërmarrjes. Ndërkaq nga Figura 3 mund të vërehet se perqindja më e madhe e blerjeve investive në vend bëhet nga ndërmarrjet e vogla (10-49 punëtorë) me 35.11%, nga ndërmarrjet e vogla (1-9 punëtorë), pasuar nga ndërmarrjet e mesme (50-249 punëtor) me 20.83% dhe ato të mëdha (250+ punëtor) me 14.6%.

Tab. 3: Struktura e blerjeve investive sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe kategorive të blerjeve investive për vitet 2023-2024

(%)

Madhësia e Ndërmarrjeve sipas numrit të punësuarve	Blerje investive në ndërtim		Blerje investive në makineri dhe pajisje		Blerje investive në produktet e pronësisë intelektuale		Blerje investive biologjike në bujqësi		Blerje investive në asete të prekshme		Gjithsej
Vitet	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2024
1-9	58.02	10.56	28.19	88.51	0.24	0.17	0.93	0.00	12.62	0.77	100.00
10-49	62.00	56.38	30.47	37.04	0.38	1.31	0.00	0.00	7.16	5.27	100.00
50-249	55.84	56.72	34.65	39.23	0.66	0.70	0.00	19.43	8.86	3.34	100.00
250+	69.03	20.31	24.90	20.53	3.51	19.49	0.00	6.53	2.57	20.24	100.00

Fig.3: Struktura e blerjeve investive sipas madhësisë së ndërmarrjeve për vitet 2023-2024, (%)



2.3. Blerjet investive sipas regjioneve


Sipas rezultateve nivel vendi, ndërmarrjet të cilat janë të përqendruara në Regjionin e Prishtinës, kanë realizuar përqindjen më të lartë të blerjeve investive me 57.95%, e pasuar nga Prizreni me 9.24%, Ferizaj me 8.60%, Peja me 7.85%, Mitrovica me 6.72%, Gjakova me 4.95% dhe Gjilani me 4.69% të totalit të blerjeve investive të realizuara gjatë vitit 2024. (shih Fig 4).

Tab. 4: Struktura e blerjeve investive sipas regjioneve dhe kategorisë së blerjeve investive për vitet 2023-2024

(%)

Regjionet	Blerje investive në ndërtim		Blerje investive në makineri dhe pajisje		Blerje investive në produktet e pronësisë intelektuale		Blerje investive biologjike në bujqësi		Blerje investive në asete të prekshme		Gjithsej investime
Vitet	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2024
Gjakovë	78.26	79.24	17.67	16.04	0.07	0.42	0.00	0.00	4.00	4.30	100.00
Gjilan	57.45	31.84	34.55	59.60	0.89	0.00	0.00	0.03	7.12	8.54	100.00
Mitrovicë	69.96	59.81	26.87	39.83	0.48	0.35	0.13	0.00	2.56	0.00	100.00
Pejë	53.04	57.70	35.19	26.46	0.18	3.70	0.23	0.00	11.36	12.14	100.00
Prizren	66.72	59.15	28.12	39.02	0.19	1.83	0.12	0.00	4.84	0.00	100.00
Prishtinë	58.19	43.71	30.78	48.31	2.21	3.95	0.07	0.00	8.75	4.03	100.00
Ferizaj	62.87	52.20	33.42	42.57	0.19	0.07	0.00	0.00	3.52	5.17	100.00

Fig.4: Struktura e blerjeve investive sipas regjioneve dhe kategorisë së blerjeve investive për vitet 2023-2024, (%)



2.4. Blerjet investive të reja, të importuara dhe blerjet investive në vijim

Në kuadrin e blerjeve të reja investive prinë sektori i Akomodimit dhe aktivitetet e shërbimit të udhqimit me 22.56%, Tregtia me shumicë dhe pakicë me 19.31%, pasuar nga Ndërtimtaria me 14,38%, Prodhimi me 13.28%. Kurse sektorët tjerë kanë përqindje më të ulët.

Sektorët të cilët prijnë në Blerje investive të importuara janë: Prodhimi me 60.65%, Tregtia me shumicë dhe pakicë me 11.98%, Informacioni dhe Komunikimi me 6.10%. Kurse sektorët tjerë kanë përqindje më të ulët.

Në Blerjet investive në vijim prijnë Tregtia me shumicë dhe pakicë me 33.76%, Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar me 22.66%, Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës me 20.67%. Kurse sektorët tjerë kanë përqindje më të ulët.


Tab. 5: Struktura e blerjeve investive të reja, të importuara dhe në vijim sipas sektorëve për vitet 2023-2024

(%)

Sektorët/ Viti	Përshkrimi i sektorëve	Blerjet investive të reja		Blerjet investive të importuara		Blerjet investive në vijim		Gjithsej blerje investive	
		2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	0.74	0.24	0.15	0.26	0.05	0.00	0.52	0.23
B	Xehetari dhe gurëthyes	1.27	0.79	0.82	0.14	0.00	1.61	0.96	0.79
C	Prodhim	18.64	13.28	48.54	60.50	14.40	1.39	21.64	16.52
D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	10.05	4.63	13.64	5.56	4.00	22.66	9.31	5.85
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	3.51	1.87	0.09	0.59	0.10	20.67	2.40	2.96
F	Ndërtimtari	17.36	14.38	4.79	2.31	46.42	0.00	21.50	12.40
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	22.66	19.31	20.48	11.98	29.65	33.76	23.76	19.57
H	Transport dhe ruajtje	9.52	3.38	5.12	0.41	0.00	3.21	7.07	3.11
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	2.00	22.56	0.73	1.94	1.80	0.00	1.80	19.31
J	Informacion dhe komunikim	1.43	7.21	0.36	6.10	0.00	5.33	1.01	6.98
K	Aktivitete financiare dhe sigurimit	1.50	1.78	1.08	4.57	0.16	0.54	1.18	1.93
L	Aktivitete të patundshmërisë	2.98	0.93	0.33	0.00	2.82	0.77	2.61	0.84
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	3.48	2.60	0.42	0.77	0.32	0.00	2.46	2.27
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	1.58	0.60	2.69	3.28	0.02	0.00	1.41	0.79
O	Administratë publike dhe mbrojtje	0.08	3.66	0.00	0.00	0.00	0.00	0.06	3.10
P	Arsim	0.67	0.48	0.13	0.00	0.20	2.89	0.50	0.59
Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	0.98	1.31	0.14	0.17	0.08	6.85	0.69	1.57
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	0.89	0.44	0.46	1.15	0.00	0.00	0.66	0.48
S	Aktivitete të shërbimeve tjera	0.66	0.55	0.01	0.00	0.00	0.05	0.45	0.47
Gjithsej		**100.00**	**100.00**	**100.00**	**100.00**	**100.00**	**100.00**	**100.00**	**100.00**

Në figurën 5 është paraqitur pjesëmarrja e secilës prej këtyre blerjeve investive (blerje investive të reja, blerje investive të importuara, blerje investive në vijim) në totalin e blerjeve investive të bëra gjatë vitit 2024. Figura është ndërtuar duke shfrytëzuar të dhënat nga tabela 1, përkatësisht totalin e blerjeve investive nga secila prej këtyre kategorive për vitin 2024. Nga figura 5 mund të vërehet se blerjet investive të reja përbëjnë rreth 85.08% të blerjeve investive totale, pasuar nga blerjet investive të importuara me 8.53% dhe ato në vijim me 6.40%.

Fig. 5: Struktura e blerjeve investive të reja, të importuara dhe blerjeve investive në vijim për vitet 2023-2024, (%)



2.5 Burimet e mjeteve për financimin e blerjeve investive


Sa i përket burimit të blerjeve investive, siç mund të shihet në tabelën 6, rreth 52.43% e vlerës së blerjeve investive të ndërmarrjeve është realizuar nga fondet e veta, 41.97% nga bankat vendore, ndërkaq burimet tjera zënë një peshë më të vogël në kuadrin e burimeve totale për blerjet investive.

Tab. 6: Burimet e blerjeve investive për vitet 2023-2024

(%)

Burimet e investimeve	Blerje investive 2023	Blerje investive 2024
Nga fondet e veta	54.92	52.43
Me bashkë-investitorët vendas	4.18	0.82
Me bashkë-investitorë të huaj	0.25	0.88
Nga bankat vendore	35.43	41.97
Nga kreditorët e huaj	0.03	0.94
Përmes leasing-ut financiar	0.81	0.17
Nëpërmjet një ujdie (kompensimi)	0.33	0.28
Huazim ose borxh si (llogari të pagueshme)	1.56	2.02
Nga fondet e qeverisë qëndrore dhe lokale	2.46	0.47
Tjetër	0.03	0.02
Gjithsej	**100.00**	**100.00**

Fig. 6: Burimet e blerjeve investive për vitet 2023-2024, (%)



3. Blerjet investive sipas kategorive

Tab. 7: Blerjet investive në ndërtim (ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore) për vitet 2023-2024

(%)

Përshkrimi	Gjithsej 2023	Gjithsej 2024
Vlera e investimeve ndërtimore	**100.00**	**100.00**
Punët ndërtimore	**79.57**	**84.22**
Ndërtesa dhe hapësira të banimit	36.81	24.96
Ndërtesa dhe hapësira jo-banimi	38.66	58.03
Ndërtime metalike	4.10	1.23
Struktura tjera ndërtimore	**20.43**	**15.78**
Infrastruktura e transportit	2.53	0.78
Tubacionet, linjat e komunikimit dhe ato elektrike	4.42	10.87
Ndërtimet komplekse industriale	10.68	1.75
Përmirësimi i tokës	0.45	0.62
Ndërtesa tjera - të pa përmendura	2.35	1.77

Tab. 8: Blerjet investive në makineri dhe pajisje për vitet 2023-2024

(%)

Përshkrimi	Gjithsej 2023	Gjithsej 2024
Makineri dhe pajisje	**100.00**	**100.00**
Pajisjet e transportit	**35.66**	**28.66**
Automjetet e udhëtareve (pasagjerëve)	14.68	9.27
Automjetet e mallrave	8.30	21.87
Automjete dhe pajisje të tjera	13.68	21.87
Makineri dhe pajisje të tjera	**64.34**	**71.34**
Produkte metalike	5.91	0.40
Makineritë e tjera për qëllime të përgjithshme	24.05	17.51
Makineritë e tjera për qëllime të veçanta	14.13	5.75
Makina dhe pajisje të tjera elektrike	4.56	7.34
Makineri bujqësore	0.20	0.03
Kompjuterë dhe pajisje kompjuterike-periferike	2.99	1.52
Pajisje të komunikimit dhe aparatet elektronike	1.95	1.75
Pajisje dhe instrumente mjekësore	1.87	1.75
Pajisje dhe instrumente tjera	7.68	10.95

Tab. 9: Blerjet investive në produktet e pronësisë intelektuale dhe aseteve me vlerë për vitet 2023-2024

(%)

Përshkrimi	Gjithsej 2023	Gjithsej 2024
Makineri dhe pajisje	**100.00**	**100.00**
Pajisjet e transportit	**35.66**	**28.66**
Automjetet e udhëtareve (pasagjerëve)	14.68	9.27
Automjetet e mallrave	8.30	21.87
Automjete dhe pajisje të tjera	13.68	21.87
Makineri dhe pajisje të tjera	**64.34**	**71.34**
Produkte metalike	5.91	0.40
Makineritë e tjera për qëllime të përgjithshme	24.05	17.51
Makineritë e tjera për qëllime të veçanta	14.13	5.75
Makina dhe pajisje të tjera elektrike	4.56	7.34
Makineri bujqësore	0.20	0.03
Kompjuterë dhe pajisje kompjuterike-periferike	2.99	1.52
Pajisje të komunikimit dhe aparatet elektronike	1.95	1.75
Pajisje dhe instrumente mjekësore	1.87	1.75
Pajisje dhe instrumente tjera	7.68	10.95

Tab. 10: Blerjet investive biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi për vitet 2023-2024

(%)

Përshkrimi	Gjithsej 2023	Gjithsej 2024
Pasuri biologjike të kultivuara dhe serrat ne bujqësi	**100.00**	**100.00**
Pasuri biologjike të kultivuara	**86.56**	**63.22**
Kopetë primare (shtazore) që japin produkte të përsëritura	17.30	0.00
Plantacionet afatgjata (më shumë se një vit)	69.27	63.22
Serrat	**13.44**	**36.78**

Tab. 11: Blerje investive të tjera ne asete të prekshme (jo të prodhuara) për vitet 2023-2024

(%)

Përshkrimi	Gjithsej 2023	Gjithsej 2024
Vlera e investimeve në asetet e prekshme jo të prodhuara	**100.00**	**100.00**
Blerja e tokës	99.87	99.95
Shpenzimet e transferimit të pronësisë mbi tokën	0.12	0.05
Blerja e produkteve të çmuara	0.01	0.00

4. Blerjet investive qeveritare

Tab. 12: Blerjet investive qeveritare për vitin 2024*

(në mijë euro)

Përshkrimi i investimeve	Qeveritë Lokale	Qeveritë Qendrore	Gjithsej 2024
Ndërtesat e banimit	2 449 765	3 097 239	5 547 004
Ndërtesa jo te banushme /Administrative Afariste	49 485 659	72 187 396	121 673 055
Ndërtimi i rrugës	88 765 250	125 775 941	214 541 191
Instalimet hidro-sanitare	11 814 891	122 973	11 937 864
Rrjete të Sistemeve të Ujësjellësit	6 946 890	1 951 803	8 898 693
Furnizim me Energji Elektrike, Gjenerimi dhe Transmetimi i Energjisë Elektrike	4 033 015	641 519	4 674 534
Pajisje të Teknologjisë Informative	978 858	11 498 123	12 476 981
Automjetet e transportit	3 794 347	20 626 446	24 420 794
Makineri	187 950	20 000	207 950
Tjera kapitale	-	-	-
Toka	11 613 592	45 492 690	57 106 282
Pasuria e paprekshme	21 267	2 274 517	2 295 784
Mobilje	372 276	1 340 970	1 713 246
Kompjuterë	75 883	684 040	759 923
Makina Fotokopjuese	-	11 886	11 886
Pajisje Speciale Mjekësore	1 474 487	12 143 107	13 617 594
Program/ Softuerë	-	4 821 337	4 821 337
Pajisje të tjera	9 793 805	32 886 235	42 680 040
Investimet ne vijim	-	106 425	106 425

**Burim Informacioni: Ministria e Financave, Thesari*

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

311:658.14(496.51)”2024”

Statistikat e Investimeve në Ndërmarrje 2024 / publikimin përgatiten Ilir T. Berisha ...[etj.]. - Botim elektronik. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2026. - 1 burim elektronik (25 f.) : ilustr. ; 28 cm. - (Statistikat Ekonomike ; Seria 3)

1. Berisha, Ilir T. 2. Bojku, Bekim 3. Syla, Violeta 4. Neziri, Guxim 5. Tmava, Vesa 6. Hoti, Valbona

ISBN 978-9951-30-111-4

Agjencia e Statistikave te Kosovës:
Përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukture organizative: Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Ne kuadër të Agjencionit veprojn edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj.

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41 Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministritë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistrues terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë qe t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa: **AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS**
Rr. ”Zenel Salihu”, nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni: +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
Fax: +383 (0) 38 235 033
E-mail: infoask@rks-gov.net
Ueb-faqe: http://ask.rks-gov.net

ISBN 978-9951-30-111-4

